

OLGER BRAME

TEKSTI DHE KONTEKSTI NË PERSPEKTIVËN SEMIOTIKE TË GJUHËS

Në punimin tonë përpiqemi të sjellim në vëmendje lidhjen që ekziston midis tekstit dhe kontekstit, parë në këndvështrimin semiotik të gjuhës. Para se të bëhet një qasje e tillë, është e nevojshme të jepet një përkufizim lidhur me këto dy koncepte.

Kur flasim për tekstin, kemi parasysh një koncept shumë të gjerë, të ndërlikuar, në të cilin ngërthehen shumë faktorë. Nëse do të kërkonim kuptimin e kësaj fjale në fjalorë të ndryshëm, do të dilnim në shumë përcaktime që lidhen me këtë fjalë-term. Teksti, nga *textus* lat., është një përzgjedhje e fjalëve të lidhura me njëra-tjetrën për të formuar bashkimin logjik dhe konceptual, duke respektuar sintaksën dhe semantikën e gjuhës së përdorur, pra gramatikën e saj dhe leksikun e saj. Termi "text" gjithashtu specifikon një sërë shenjash të tilla si gjetet, shprehjet e fytyrës, mënyrën e të shprehurit; në një kuptim, teksti mund të përcaktohet si çdo mjet komunikimit. Pra, këto përcaktime bazohen te pjesët e diçkaje të shkruar, të folur, si një veprim, si mënyrë për të performuar gjuhën, si shenjë dhe sistem shenjash, etj.¹ Në aspektin gjuhësor, teksti është një bashkësi shenjash gjuhësore të ndërliqura që përdoren për qëllime komunikative, pra është një madhësi semiotike².

Fjala "tekst" është përdorur në gjuhësi për t'iu referuar çdo pasazhi, të folur ose të shkruar, që si rezultat i proceseve të kohezionit dhe koherencës formon një tërësi të unifikuar³.

Duke përligjur këtë ndërliqësi të nocionit tekst, mund të konceptojmë më së miri atë me çka semiologu i njohur Umberto Eco, ka cilësuar tekstin si "një botë e hapur".

¹ Për më tepër shih. Collins English Dictionary në <http://www.collinsdictionary.com/dictionary/english/text> dhe <http://www.learnersdictionary.com/definition/text>

² D. Chandler, D. *Semiotic for Beginners* në <http://visual-memory.co.uk/daniel/Documents/S4B/sem01.html>

³ M. Bronwen and R. Felizitas, *Dictionary of Semiotics*, 2000, f. 133.

Termi kontekst, përcakton çdo tekst që i paraprin ose shoqëron çdo njësi të veçantë të nënkuptuar dhe në të cilën varet kuptimi i saj. Konteksti, në këtë kuptim, mund të jetë eksplisit, i nënkuptuar ose situacional. Nocioni i kontekstit në traditën sistematike funksionale është i bazuar në një term të zhvilluar fillimisht nga gjuhëtarit britanik J. R. Firth (1957), i cili i referohet asaj që ai e quajti "konteksti i situatës" (term në fakt rrjedh fillimisht nga antropologu Bronislaw Malinowski⁴. Sipas Halliday-it: "Konteksti sipas këtij modeli është të një konstrukt i përbërë nga domethënie kulturore, e cila realizohet funksionalisht në formën e akteve të kuptimit në mënyra të ndryshme semiotike, prej të cilave, një nga proceset e vazhdueshme është gjuha. Proceset e vazhdueshme prej zgjedhjes gjuhësore, me anën e të cilit një folës është përzgjedhur brenda burimeve të sistemit gjuhësor, janë zgjedhje që bëhen në mënyrë efektive kulturore dhe aktet e kuptimit janë gjithashtu akte kulturore"⁵.

Nëse një tekst e konsiderojmë një shenjë gjuhësore, atëherë duhet të mbajmë parasysh se gjuha nuk është vetëm manifestim i asaj çfarë është shkruar apo folur nëpërmjet këtij teksti, nuk është vetëm zbatim rregullash gramatikore, por edhe ndërveprim dhe komunikim, pra me pak fjalë, me elementin pragmatik të saj, pasi gjuha shërben për të komunikuar, d.m.th., për të dhënë informacion dhe në shumë raste përdoret për të pohuar, d.m.th., për të transmetuar informacion përshkrues.

Nocioni i "tekstit" është më popullor dhe më i diskutuari brenda fushave të ndryshme të shkencave humane dhe sociale. Filologjia dhe gjuhësia, teoria e letërsisë dhe kritika e artit, teoria estetike, filozofia e gjuhës, etnologjia, sociologjia dhe psikanaliza, të gjitha referohen në mënyra të ndryshme në "tekst" për ta bërë objekt themelor të hetimeve të tyre. Teksti në historinë e semiotikës, gjen vendin e tij që nga reflektimet e para të lashta filozofike si shenjë gjuhësore, deri në parametrat më moderne të propozuara nga semiotika e tekstit. Maria Pia Pozzato në veprën e saj "*Semiotica del testo*" thekson se semiotika e tekstit si një semiotikë zbatuese, përbën një fushë disiplinore studimi, e cila objektin e saj të studimit e shtrin mbi faktin se si qeniet njerëzore shenjojnë e komunikojnë mes tyre⁶. Pra, semiotika, si teori e shenjave, të cilat shërbejnë si bazë për çdo akt komunikimi dhe informimi, është e

⁴ Po aty, f. 43.

⁵ M. A. K. Halliday and R. Hasan, *Language, context and text*, Oxford University Press, 1989, f. 44-46.

⁶ Shih: M. P. Pozzato, *Semiotika del testo*, Carocci editore, S.P.A Roma.

nevojshme për të analizuar dhe për të menaxhuar komunikimin si proces shenjor.

Në kuadrin e fushës së studimit të semiotikës së tekstit, duhet mbajtur parasysh edhe fakti tjetër se me termin "tekst" do të kuptohet çdo lloj teksti, jo vetëm teksti i shkruar, por edhe teksti me gojë, portreti, fotot, reklamat e kështu me radhë; me pak fjalë, të gjitha tekstet që kanë të bëjnë me ne si komunikues. Pra objekti i semiotikës së tekstit përfshin tekstin dhe gjithçka që lidhet me tekstin ose interpretohet si tekst.

Në përgjigje të asaj se çfarë është teksti, Barthes, në veprën e tij "*Aventura semiologjike*" e evidenton tekstin jo në një kuptim të ngushtë e kanonik të një përkufizimi të thjeshtë, por shumë më tepër se kaq. Ai thekson se teksti është edhe praktikë shenjuese, edhe strukturim, vëllim gjurmësh në zhvendosje. Teksti nuk është domethënia, por shenjuesi⁷.

Teoritë apo drejtimit që lidhin semiotikën me tekstin siç shihet edhe nga përcaktimet për tekstin, janë të ndryshme. Kështu Vladimir Propp dhe formalizmi rus si drejtim të cilit i përkiste ai, e përqendroi vëmendjen kryesisht në analizat e teksteve letrare e artistike e për më tepër në atë që ka të bëjë me abstragimin e kuptimit⁸; Hjelmslev në teorinë e tij mbi tekstin në këndvështrimin semiotik futi konceptin e rrafshit të shprehjes gjuhësore dhe rrafshit të përmbajtjes; Benveniste në konceptimin e tij u mor me tërësinë e shenjave si tekst, nga ku veçon gjuhën si sistemin më të plotësuar. Sipas tij gjuha si sistem shërben si shtrat mbi të cilin vendoset gjuha që i përket një ligjëruesi në situatë, vend e kohë të caktuar⁹; Greimas u fokusua në receptimin e tekstit letrar, raportin midis ligjëruesit dhe rrëfimit, ku dallon tri kategori të dyfishta: subjekt/objekt, dhënës/marrës, kundërvënës /ndajshues.

Çështjet që kanë të bëjnë me ligjëruesin shtrohen në gjuhësi dhe pjesa tjetër i përket semiotikës letrare, duke futur këtu edhe konceptin mbi konotacionin dhe denotacionin dhe ndërthurjen e tyre. Nga ana tjetër Lotman duke iu përmbajtur përkufizimit semiologjik, me ligjërimin kupton çdo sistem komunikimi që përdor shenja duke e ndarë në disa rrafsh me hierarki të caktuar dhe duke veçuar shprehjen, kufijtë dhe karakterin strukturor. Teksti ka një shenjëzim të vetëm që shqyrtohet si një shenjë

⁷ R. Barthes, *Aventura semiologjike*, përkth. R. Ismajli, Dukagjini, Pejë, 2008, f. 38-39.

⁸ D. Olshansky, *Vladimir Propp*. The Literary Encyclopedia. First published 19 May 2008.

⁹ A. Duro, *Leksione të teorisë së komunikimit*, QSA, Tiranë, 2010.

sinjal e pandashme. Duke qenë i tillë, ai u kundërvihet strukturave jashtëtekstore dhe gjithë shenjave të tjera që nuk hyjnë në një tërësi sipas parimit të përfshirjes/mospërfshirjes¹⁰.

Është argumentuar se kuptimi kalon vetëm nëpërmjet teksteve, të cilët janë vendi ku kuptimi është prodhuar dhe prodhon në këtë “pëlhurë tekstuale” shenjat e fjalorit, si njëvlefshmëri të koduara, që mund të rishfaqen për aq kohë sa “kuptimi zbehet dhe vdes”. Një tekst nuk është vetëm mjet komunikimi, por është një sistem që vë në pikëpyetje sistemet e kuptimit që paraekzistojnë; shpesh i rinovon, por nganjëherë i shkatërron ato¹¹. Teksti, nga ana semiotike, mund të përcaktohet si radhë e pjesëve të bashkërenditura të shenjave gjuhësore, të një përbërësi më të madh ose më të vogël, i cili përdoret për qëllime komunikative.

Teksti, si madhësi semiotike, është krijim i veprimtarisë komunikative të njerëzve, është një kompleks shenjash gjuhësore, që në vetëdijen e autorit krijojnë një përmbajtje, e cila mund të realizohet përmes renditjes së tingujve, fjalëve dhe njësive të tjera gjuhësore sipas rregullave të sistemit të gjuhës¹².

Kur flitet për kontekstin, jemi në rrafshin pragmatik të gjuhës. Sjellim në vëmendje faktin se merita e përdorimit bashkëkohor të termit “*pragmatikë*” i takon filozofit Çarls Moris, i cili bëri përpjekje për të vendosur kufijtë e shkencës që merret me studimin e shenjave pra, *semiotikës*, brenda së cilës ai dalloj tri drejtime kryesore studimi: *sintaktikën*, që është studimi i marrëdhënieve formale mes shenjave; *semantikën*, që është studimi i marrëdhënieve midis shenjave dhe objekteve; *pragmatikën*, që është studimi i marrëdhënieve mes shenjave dhe përdoruesve (interpretuesve) të tyre. Sipas Morisit, fusha e pragmatikës gjuhësore nuk mund të përfshijë çdo aspekt që ka lidhje me përdoruesit dhe përdorimin e shenjave gjuhësore¹³. Në përkufizimet e bëra për pragmatikën, një rol të pazëvendësueshëm zë dhe konteksti. Ky qëndrim është përkrahur mes gjuhëtarësh dhe filozofësh, si Ostini, Sërli,

¹⁰ R. Ismajli, *Shumësia e tekstit*, Rilindja, Prishtinë, 1980, f. 78-82 dhe Grigorieva, J., *Lotman's concept of sign, narrative and mimesis*, në Amsterdam International Electronic Journal for Cultural Narratology (AJCN, 2011).

¹¹ Shih: U. Eco, *Semiotica e filosofia del linguaggio*, G. Einaudi, Torino Editore s.p.a, Torino (1984), ristampa 2012.

¹² H. Mujaj, *Gjuhësia e tekstit*, Shtëpia Botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2004, f. 26-27

¹³ Ch. W. Morris, *Foundations of the Theory of Signs*, International Encyclopedia of Unified Sciences, Chicago: University of Chicago Press, 1938, f. 6-7.

Llajonsi etj. Sipas tyre, *pragmatika është studimi i aftësisë së përdoruesve të gjuhës për të lidhur fjalitë (tekstet) me kontekstet në të cilat ato do të përshtateshin*¹⁴.

Pra nëse fjalët brenda një teksti merren si të veçuara, mund të na dalin shumëkuptimshme dhe vetëm brenda kontekstit në të cilin gjenden, ato mund të dalin me kuptimin e tyre të vetëm. Vetë teksti është krijuar si shenjë duke iu referuar trekëndëshit semiotik, i cili ka tre elemente: shenjuesin, të shenjuarin dhe referentin (realitetin që i referohet shenja). Sipas Tefë Topallit, nocioni i tekstit konsiderohet si uniteti themelor i komunikimit verbal; ai konsiston në një mesazh, i cili jepet nëpërmjet çdo kanali (të shkruar a të folur), që shpreh një temë të lidhur në kuadër të koherencës semantike e kohezionit sintaksor, sipas situatës së aktit të komunikimit, ndërsa konteksti tregon koordinimin e pjesëve të një diskursi, bashkimin organik të një shkrimi, kurorën e tij gjuhësore (fjalët pararendëse e vijuese) dhe jashtëgjuhësore (kuptimet e fjalëve, rrethanat, tonin e zërit, rolin i bashkëbiseduesit) që ndihmon për të përcaktuar kuptimin e mesazhit¹⁵.

Për Ferdinand de Saussure konteksti është shfaqje e situatës e cila është element i rëndësishëm në komunikim. Semiologjia merr në studim jo vetëm çfarë njihet si një shenjë në një analizë gjuhësore të ligjëritimit të njeriut, por, ajo merr në konsideratë gjithë kontekstin (situatën) në të cilën thuhet fjalët.¹⁶ Halliday dhe Hasan (1989) shpalosin analizën e tyre në disa aspekte të lidhura me njëri-tjetrin ku përmendim:

a- ajo që ndodh dhe veprimeve e përfshirë në situatën e diskursit (në terren)

b- rolet sociale të pjesëmarrësve

c- retorika- mënyra dhe roli e caktuar për gjuhën. argumentojnë se nocioni kontekst jo vetëm që ndihmon në shpjegimin e ndërtimeve ideosinkretik të kuptimit dhe vështirësitë e veçanta në komunikim, por edhe llogarit se sa kuptimet e përbashkëta dhe pritshmëritë, bëjnë të mundur një komunikimi efektiv.¹⁷ Pra, më shumë se diçka e përbërë nga fjalitë, teksti duhet menduar si një diçka e koduar në fjali. Në këtë rast kodi

¹⁴ S. C. Levinson, *Pragmatics*, Cambridge University Press, 1983, f. 16-18 & H. P. Grice, *Meaning*, *Philosophical Review* 66, f. 377-88, 1957; edhe në Grice, f. 213-23, 1989.

¹⁵ T. Topalli, *Gjuha dhe shkrimtari*, Shkodër, 2001, f. 107-108.

¹⁶ F. de Saussure, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria, Tiranë.

¹⁷ M. A. K. Halliday and R. Hasan, *Language, context and text*, Oxford University Press, 1989, f. 29-34

lidhet me parimin organizimit semiotik të kuptimit, i cili rregullon zgjedhjen e domethënies nga një folës dhe interpretimin e saj nga dëgjuesi. Nga ana tjetër, elementet jashtëgjuhësore ndihmojnë zbërthimin kontekstual të tekstit.

Duke ndarë qartazi kontekstin e situatës nga konteksti kulturor, Halliday thekson se konteksti i kulturës i referohet kulturës dhe sfondit ideologjik të shoqërisë ku funksionon teksti. Në aspektin semiotik kultura paraqitet si një fushë me interes studimor. Ky aspekt semiotik i kulturës është studiuar sidomos nga Lotmani, i cili e përcakton kulturën si kujtesë apo si regjistrim i kujtimit të diçkaje që është përjetuar nga komuniteti dhe jo si "kujtim" i trashëguar i tij (komunitetit)¹⁸. Megjithatë, Lotmani thekson qartazi se kultura nuk është një depo statike e informacionit. Kultura ruan informacionin e ri që merr në një proces të vazhdueshëm të kodimit dhe deshifrimit të tekstit, mesazheve, etj. që vijnë nga kultura të tjera. Ai thotë se kultura punon në sfond të asaj që quhet jokultura, e cila tregon një hapësirë tjetër kulturore, me kode të ndryshme. Në aspektet e saj dinamike kultura asimilon tekste, i përkthen ato në gjuhën e saj, hyn në dialog me jokulturën, duke prodhuar vazhdimisht informacion të ri¹⁹.

Në këtë vështrim, nëse gjuha shihet si sistemi parësor, kultura është një sistem dytësor, e cila i ndërton modelet e saj, duke u bazuar në sistemin gjuhësor.

BIBLIOGRAFI

- Barthes, R., *Aventura semiologjike*, përkth. R. Ismajli, Dukagjini, Pejë, 2008, f. 38-39.
- Bronwen M. and Felizitas R., *Dictionary of Semiotics*, 2000, f. 133.
- Chandler D. *Semiotic for Beginners*, në <http://visual-memory.co.uk/daniel/Documents/S4B/sem01.html>
- Duro, A., *Leksione të teorisë së komunikimit*, QSA, Tiranë, 2010.
- Eco, U., *Semiotica e filosofia del linguaggio*, G. Einaudi, Torino Editore s.p.a, Torino (1984), ristampa 2012.
- De Saussure, F. *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria, Tiranë.
- Grigorieva, J., *Lotman's concept of sign, narrative and mimesis*. në Amsterdam International Electronic Journal for Cultural Narratology (AJCN, 2011).

¹⁸ Lotman e Uspenskij, *Ricerche semiotiche* në Tesi per una semiotica delle culture, Meltemi editore, Roma, 2006.

¹⁹ Po aty.

- Halliday M. A. K., and Hasan R., *Language, context and text*, Oxford University Press, 1989, f. 29-34; f. 44-46.
- Ismajli, R., *Shumësia e tekstit*, Rilindja, Prishtinë, 1980, f. 78-82.
- Levinson, S. C., *Pragmatics*, Cambridge University Press, 1983, f. 16-18
- & Grice, H. P., *Meaning*, *Philosophical Review* 66, f. 377–88, 1957.
- Lotman e Uspenskij, *Ricerche semiotiche* në Tesi per una semiotica delle culture, Meltemi editore, Roma, 2006.
- Morris, Ch. W., *Foundations of the Theory of Signs*, International Encyclopedia of Unified Sciences, Chicago: University of Chicago Press, 1938, f. 6-7.
- Mujaj, H., *Gjuhësia e tekstit*, Shtëpia Botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2004, f. 26-27.
- Olshansky, D., *Vladimir Propp*. The Literary Encyclopedia. First published 19 May 2008.
- Pozzato, M. P., *Semiotika del testo*, Carocci editore, S.P.A Roma.
- Topalli T., *Gjuha dhe shkrimtari*, Shkodër, 2001, f. 107-108.
- <http://www.collinsdictionary.com/dictionary/english/text>
- <http://www.learnersdictionary.com/definition/text>

GJUHËSI E ZBATUAR / B

